

Letër nga Familja e Prof.Arben Dërmakut, për të pranishmit në mbledhjen komemorative ne UKZ,

Inderuar Rektor Bajram Kosumi, dhe të gjithë ju të pranishëm!

Në pamundësi që të jemi fizikisht me ju në këtë mbledhje, ju falënderojmë një nga një të gjithë juve që jeni mbledhë sot këtu, për të përkujtuar Arbenin dhe për të ndarë dhimbjen me ne. Ky organizim dhe kjo prezencë e juaja, na e lehtëson, sadopak, këtë dhimbje të madhe që kemi si familje, për humbjen kaq të hershme të Arbenit. E çmojmë shumë respektin dhe vlerësimin që keni për Profesor Arbenin ku një pjesë e juaj keni qenë edhe bashkëpunëtorë të ngushtë me te për ta themeluar këtë Universitet ku ai kishte barrën për ta udhëhequr procesin.

Ju dëshirojmë shëndet ju dhe familjeve të juaja, në këtë kohë të këtij virusi të pamëshirshëm i cili po shkakton dhimbje në shumë e shumë familje anekënd globit.

Me respekt,

Familja e ngushtë e Arbenit: Fadili, Naxhija, Merita, Doni dhe motrat Arbana e Arditë

Prishtinë,

14 janar 2021